

ANDREA LLUKANI

**DIKUSH DUHET TË NDREQË
ATË QË ËSHTË PRISHUR**

KOMENTI I LETRËS SË PAVLIT DREJTUAR TITIT

Botimet “Trifon Xhagjika”

Tiranë, 2011

Redaktor: **Dr. Moikom Zeqo**

Në ballinë: Studentë shqiptarë në rezidencën e patrikut.

PARATHËNIE

Letra drejtuar Titit është një version i shkurtuar i dy letrave drejtuar Timotheut. Apostull Pavli e këshillon episkopin e Kretës, Titin si të përzgjedhë me kujdes prezbiterët e kishës (1, 5-9), rreth mësimit të rremë (1, 10-16), rreth ndihmës që duhet të japë ndaj grupimeve të ndryshme shoqërore (2, 1-10) etj. Në letër bëhet fjalë për drejtuesit kishtarë, pra ata që kanë detyra me përgjegjësi në kishë. Pjesa më e rëndësishme e letrës përshkruan kërkesat për shërbesat pastorale të episkopit. Në kreun e parë, vargjet 7-9 bëjnë fjalë për cilësitë që duhet të ketë episkopi. *“Sepse episkopi duhet të jetë i pafajshëm, si kujdestar i Perëndisë; jo i vrazhdë, jo zemërak, jo pijanec, jo grindës, jo njeri që lakmon në fitim të lig, por dorëhapët, mirëdashës, i urtë, i drejtë, i shenjtë, i përmbajtur; i ngjitur pas fjalës së vërtetë sipas mësimit që mori, që të mundë dhe të nxisë të tjerë me anë të mësimit të shëndoshë, dhe të qortojë ata që flasin kundër”*.

Në Dhiatën e Re, sidomos në shkrimet e apostull Pavlit termi episkop shpesh njësohet me termin prezbiter. Kjo ndodh, sepse në kishën e hershme ndryshimi ndërmjet episkopit dhe prezbiterit ishte fare i vogël. Fjala prezbiter është me origjinë hebraike dhe ka kuptimin *plak*, ndërsa termi episkop rrjedh nga greqishtja dhe do të thotë *mbikqyrës*. Kjo fjalë tregon për natyrën mbikqyrëse të shërbesës së episkopit.

Titi ka qenë bashkëpunëtor i apostull Pavlit. Ndonëse Lluka nuk e përmend tek Veprat e Apostujve, Titi bëhet i njohur me anën e letrave të Pavlit. Përsa i përket origjinës, Titi ishte grek i parrethprerë (Galatasve 2, 1-5), megjithatë Pavli nuk e detyroi atë të rrethpritej. Titi ka shoqëruar Pavlin dhe Barnabën në udhëtimin e dytë misionar nga Antiokia drejt Jeruzalemit për të marrë pjesë në sinodin apostolik. Të dhëna të tjera rreth aktivitetit misionar të Titit kemi gjatë udhëtimit të tretë misionar, atëhere kur Pavli e dërgoi nga Efesi për në Korinth (II Korintasve 2, 13). Titi pati sukses në misionin e tij, sepse i bindi korintasit të dërgonin ndihma për vëllezërit e Jeruzalemit (7, 6, 13). Pavli pasi e kishte dërguar letrën me Titin priste me padurim të dëgjonte si e kishin pritur korintasit. Më vonë Titi u takua me Pavlin në Maqedoni ku e informoi për punën e kënaqshme në Korinth. Në vijim Pavli e dërgoi përsëri në Korinth për të përgatitur vizitën e dytë të tij (II Korintasve 8, 6, 12, 18). Titi ishte personalitet i fuqishëm, prandaj Pavli i besoi detyra të rëndësishme. Të dhëna të tjera rreth Titit kemi tek (II Timotheut 4, 10) ku Pavli e dërgoi nga Roma për në Dalmaci. Më pas Pavli e emëroi Titin episkop të Kretës me qëllim të organizonte kishën. Në kohën që shkroi letrën, Pavli gjendej në Maqedoni dhe prej andej dërgoi për në Kretë Artemin dhe Tikikun me porosi për Titin, sepse bëhej fjalë të vizitonte Nikopojën. Pavli dimëroi në Nikopojë të Epirit. Sipas traditës letra drejtuar Titit u shkrua prej Pavlit në Nikopojë në vitet 64 ose 65 pas Krishtit. Letrat e Pavlit drejtuar Timotheut dhe Titit quhen letra pastorale. Quhen me këtë emër, sepse u drejtohen barinjve të kishave dhe trajtojnë çështje të organizimit të kishave lokale. Libri “Dikush duhet të ndreqë atë që është prishur” nuk është botim zyrtar i K.O.A.Sh-it, por një përpjekje vetjake e autorit për të dhënë në gjuhën shqipe pjesë

nga komenti i Shkrimit të Shenjtë. Teksti me shkronja kursive është marrë nga një version i Biblës në internet, ndërsa poshtë jepet komenti. Për të qenë sa më i saktë me frazeologjinë teologjike në tekst kam përdorur disa fjalë dhe fraza në greqishten bizantine.

Libri “Dikush duhet të ndreqë atë që është prishur” është aktual edhe në kohën e sotme. Me interesimin e Kryepiskopit Anastas mjaft seminaristë janë dërguar jashtë shtetit për të kryer shkolla të larta teologjike në Greqi. Ja disa prej tyre: Pavli Dimashi, Janaq Gjica, Dhimitër Qosja nga Elbasani, Spiro Nika, Apostol Kaci nga Gjirokastra, Artem Cici, Spiro Papa nga Saranda, Jorgo Papadhopulli, Andrea Llukani, Alfred Bushaka, Andon Merdani nga Tirana, Maksim Çuko nga Krutja e Lushnjës, Artur Gjeka, Joan Lena nga Kolonja e Lushnjës, Nikolla Hyka nga Zhupani i Fierit, Gjergji Kureta nga Bestrova e Vlorës, Gjergji Simaku, Grigor Fiku, Thoma Shkira, Kozma Prifti nga Korça, Aleksandër Vasili nga Pogradeci, Joan Mili, Harallamb Tereziu nga Kavaja, Vlash Plepi, Kristaq Bakallbashi, Violeta Plepi, Spiro Kostoli, Joan Meni nga Durrësi, Aleks Çuri nga Përmeti, Marina Baba, Joan Qako, Theodhor Peci, Irine Pandelejmoni etj.

Kryepsalti Harallamb Tereziu dhe psalti i talentuar Aleks Çuri po kontribuojnë në kishën e Ungjillëzimit në Tiranë, Joan Meni është kryepsalt në kishën e Shën Prokopit dhe Theodhor Peci ka botuar disa libra liturgjike. Disa të tjerë janë mësimdhënës në Akademinë Teologjike dhe të tjerë kanë përqafuar jetën monakale, por është për të ardhur keq kur vërren se një munër i madh teologësh gjenden jashtë kishës. Për ta kisha ka shpenzuar shumë, prandaj duhet të rikthehen një ditë. Ata nuk janë të pakët: 1-Spiro Nika, arkeolog, teolog, 2-Apostol Kaci,

regjisor, teolog, 3-Artem Cici, agronom, teolog, psalt, 4-Andrea Llukani, shkrimtar, teolog, 5-Arjan Koja, arkimandrit, doktor në të Drejtën Kanonike, 6-Gjergji Simaku, arkimandrit. Kësaj liste i shtohen edhe Joan Lena, Joan Mili, Aleksandër Vasili, Spiro Papa, Gjergji Kureta, Artur Gjeka etj. Është në nderin e Fortlumturisë së Tij, Anastasit të kthejë përsëri në kishë të larguarit sepse “vreshti i Perëndisë kërkon punëtorë të rinj” thuhet në Bibël. Patriku Ekumenik Bartolomeu I gjatë vizitës që bëri në Akademinë Teologjike “Ngjallja e Krishtit” në Shën Vlash të Durrësit, më 5 qershor të vitit 2002 ndër të tjera tha: “Tashmë bijtë e mi të dashur përgatituni në mënyrë që të vazhdoni këtë mrekulli të Ngjalljes. Fortlumturia e tij ndërtoi themelet e kësaj Kise, që ecurinë e mëtejshme të saj ta vazhdoni ju”.

LETRA E APOSTULL PAVLIT

DREJTUAR TITIT

KREU I PARË

Drejtimi dhe përshëndetjet (1, 1-4)

1. Pavli, shërbëtor i Perëndisë, dhe apostull i Jisu Krishtit, sipas besimit të të zgjedhurve të Perëndisë, dhe sipas njohjes së të vërtetës që është sipas përkushtimit, 2 me shpresë për jetën e përjetshme, të cilën e premtoi Perëndia që s'gënjen përpara kohëve të përjetshme, 3 edhe shfaqti në kohë të caktuara fjalën e tij me anë të predikimit që m'u besua mua sipas urdhrat të Shpëtimtarit tonë Perëndi; 4 Titos, birit të thjeshtë sipas besimit tonë të përbashkët, i qoftë hir, përdëllim, paqe prej Perëndisë Atë, dhe prej Zotit tonë Jisu Krisht, Shpëtimtarit tonë.

-Pavli, shërbëtor i Perëndisë, dhe apostull i Jisu Krishtit. Të dhëna për jetën dhe veprimtarinë e apostull Pavlit gjejmë tek Veprat e Apostujve dhe në Letrat e tij. Në lidhje me origjinën ai shprehet: “U rrethpreva në të tetën ditë, jam nga kombi i Izraelit nga fisi i Beniaminit, hebre nga hebrej dhe sipas ligjit farise” (Filipianëve 3, 5). Pavli ka lindur në qytetin Tarso të Kilikisë, nga prindër judej të diasporës, të cilët gëzonin të drejtën

civile romake (Veprat e Apostujve 22, 3). Emri i tij ishte Saul dhe shkonte në shkollën e Sinagogës. Gjithashtu ushtronte zanatin e thurrësit të tendave. Më vonë studioi te fariseu Gamaliel dhe përgatitej të bëhej Rabin. Sauli ishte fanatik në fenë judaike dhe persekutonte pa mëshirë të krishterët. Ai mori pjesë në vrasjen me gurë të Stefanit. Cilësimi i Pavlit si shërbëtor i Perëndisë nuk e hasim tek letrat e tjera, sepse Pavli ka preferuar termin skllav i Jisu Krishtit (Romakëve 1, 1, dhe Filipianëve 1, 1).

-Apostull i Jisu Krishtit. Apostull Pavli e prezanton veten si apostull i Jisu Krishtit jo për të bindur Titin, i cili ishte dishepull i tij, por për të bindur grigjën e Kretës, të cilëve u drejtohet kjo letër. Në përshëndetjen drejtuar Titit, Pavli thekson dhuntinë e tij apostolike. Nga trembëdhjetë letrat që ka shkruar, në nëntë prej tyre Pavli e quan veten *apostull i Jisu Krishtit*. Gjithashtu ai e quan veten të barabartë me dymbëdhjetë apostujt e Krishtit (Lluka 6, 13-16).

-Sipas besimit të të zgjedhurve të Perëndisë. Apostull Pavli është i zgjedhuri i Perëndisë. Duke zbatuar porosinë e Krishtit “*Shkoni pra e mësoni gjithë kombet dhe i pagëzoni në emrin e Atit e të Birit dhe të Shpirtit të Shenjtë*” (Mateu 28, 19) filloi aktivitetin misionar për përhapjen e krishterimit anembanë botës. I zgjedhur i Perëndisë është edhe populli izraelit “*Po ju jeni “brez i zgjedhur, priftëri mbretërore, komb i shenjtë”, popull që fitoi Perëndia, që të tregoni mirësitë e atij që ju thirri nga errësira në dritën e tij të çuditshme*” (I Petros 2, 9). Të zgjedhurit e Perëndisë janë gjithë të krishterët “*Të zgjedhur sipas paranjohjes së Perëndisë, Atit, me anë të shenjtërimit të Shpirtit, për dëgjim e spërkatje të gjakut të Jisu Krishtit; hir dhe paqe u shumofshin mbi ju*” (I Petros 1, 2).

-Me shpresë për jetën e përjetshme. Pavli është shërbëtor i Perëndisë dhe apostull i Jisu Krishtit, sepse shpreson në jetën e përjetshme *“Po prandaj u përdëlleva, që të tregojë Jisu Krishti më përpara tek unë gjithë zemërgjerësinë, për shembull mbi ata që kanë për t’i besuar atij për jetë të përjetshme”* (I Timotheut 1, 16).

-Të cilën e premtoi Perëndia. Perëndia e ka premtuar jetën e përjetshme me anën e profetëve dhe të shkrimeve të shenjta *“Që qe premtuar që përpara me anë të profetëve të tij në shkrime të shenjta”* (Romakëve 1, 2). Perëndia atë që premtonte e bën realitet *“E duke qenë i bindur se atë që i premtoi Zoti është i fuqishëm edhe ta bëjë”* (Romakëve 4, 21).

-Edhe shfaqti në kohë të caktuara fjalën e tij. Kohët janë të pacaktuara, por konkrete dhe të sakta *“Edhe që u shfaq tani me anë të dukjes së shpëtimtarit tonë Jisu Krisht, i cili prishi vdekjen, dhe nxori në dritë jetën dhe pavdekësinë me anë të ungjillit”* (II Timotheut 1, 10). Jeta e përjetshme do të vijë kur të jetë koha e përshtatshme *“Që dha veten e tij shpërblim për të gjithë, për dëshmi në kohë të urdhëruara”* (I Timotheut 2, 6).

-Me anë të predikimit që m’u besua mua. Apostull Pavlit iu besua predikimi i Ungjillit *“Sipas ungjillit të lavdisë së të lumturit Perëndi, që m’u besua mua”* (I Timotheut 1, 11). Ky premtim iu dha jo me urdhërin e ndonjë njeriu, por *“Sipas urdhrit të Perëndisë, shpëtimtarit tonë, dhe të Zotit Jisu Krisht, shpresës sonë”* (I Timotheut 1,1).

-Titos, birit të thjeshtë. Titi përmendet në Dhiatën e Re në debatin për rrethprerjen *“Pas katërmbëdhjetë vjetësh, përsëri u ngjita në Jerusalem bashkë me Varnavën, si mora me vete*

edhe Titon” (Galatasve 2,1). Titi ka qenë bashkëpunëtor i apostull Pavlit. Ndonëse Lluca nuk e përmend tek Veprat e Apostujve, Titi bëhet i njohur me anën e letrave të Pavlit. Përsa i përket origjinës, Titi ishte grek i parrethprerë (Galatasve 2, 1-5), megjithatë Pavli nuk e detyroi atë të rrethpritej. Ai ka shoqëruar Pavlin dhe Barnabën në udhëtimin e dytë misionar nga Antiokia drejt Jeruzalemit për të marrë pjesë në sinodin apostolik. Të dhëna të tjera rreth aktivitetit misionar të Titit kemi gjatë udhëtimit të tretë misionar, kur Pavli e dërgoi atë nga Efesi për në Korinth (II Korintasve 2,13). Në letrën e dytë drejtuar Korintasve Pavli e përmend emrin e Titit nëntë herë. Titi pati sukses në misionin e tij, sepse i bindi korintasit të dërgonin ndihma për vëllezërit e Jeruzalemit (7,6,13). Pavli pasi e kishte dërguar letrën me Titin priste me padurim të dëgjonte si e kishin pritur korintasit. Më vonë Titi u takua me Pavlin në Maqedoni ku e informoi për punën e kënaqshme në Korinth. Në vijim Pavli e dërgoi në Korinth për të përgatitur vizitën e dytë të tij atje (II Korintasve 8, 6, 12, 18). Titi ishte personalitet të fuqishëm, prandaj Pavli i besoi detyra të rëndësishme. Të dhëna të tjera rreth Titit kemi tek (II Timotheut 4, 10) ku Pavli e dërgoi nga Roma për në Dalmaci. Më pas Pavli e emëroi Titin episkop të Kretës me qëllim të organizonte kishën.

Termi përdoret për fëmijët legjitimë, por siç e dimë apostull Pavli ka qenë i pamartuar, pra nuk ka pasur fëmijë, por ai kishte bij shpirtërorë. Prej gjithë bijve shpirtërorë që kishte apostull Pavli, Titi ishte më i miri, prandaj e quan *αἰβόει ὁ Ἰτί*.

-Sipas besimit tonë të përbashkët. Titi përqafoi besimin e krishterë prej Pavlit, prandaj ky i fundit e konsideronte si bir të tij *“Nuk i shkruaj këto për t’ju turpëruar ju, por ju këshilloj si bij të mi të dashur. Sepse edhe sikur të keni dhjetë mijë mësues*

në Krishtin, po nuk keni shumë etër; sepse unë ju linda në Krishtin Jisu me anë të ungjillit” (I Korintasve 4, 14-15).

-I qoftë hir, përdëllim, paqe prej Perëndisë Atë. Apostull Pavli i uron dishepullit të tij që Perëndia t’i dhurojë hir, mëshirë dhe paqe. Ata që predikojnë ungjillin kanë nevojë për hirin e Perëndisë me qëllim që t’i ndriçojë në punën e tyre. Kanë nevojë për përdëllimin e Perëndisë. Gjithashtu edhe për paqen. Të tri këto dhurata vijnë nga Perëndia Triadik.

-Prej Zotit tonë Jisu Krisht, Shpëtimtarit tonë. Perëndia është shpëtimtari ynë. Krishti është Biri i Perëndisë, i cili erdhi në botë për shpëtimin tonë. Krishti është shpresa jonë. Ky fakt theksohet edhe në një varg tjetër të letrës: “...sepse shpresuam në Perëndinë e gjallë, i cili është shpëtimtari i gjithë njerëzve, po më fort i besimtarëve” (I Timotheut 4, 10).

Zgjedhja e barinjve në kishën e Kretës (1, 5-9)

5 Prandaj të lashë në Kretë, që të ndreqësh të metat, dhe të vendosësh në çdo qytet pleq siç të urdhërova unë: 6 kush të jetë i pafajshëm, burrë i një gruaje, që ka bij besimtarë që s’përfliten për plangprishës ose për të pabindur. 7 Sepse episkopi duhet të jetë i pafajshëm, si kujdestar i Perëndisë; jo i vrazhdë, jo zemërak, jo pijanec, jo grindës, jo njeri që lakmon në fitim të lig, 8 por dorëhapët, mirëdashës, i urtë, i drejtë, i shenjtë, i përmbajtur; 9 i ngjitur pas fjalës së vërtetë sipas mësimit që mori, që të mundë dhe të nxisë të tjerë me anë të mësimit të shëndoshë, dhe të qortojë ata që flasin kundër.

-*Të lashë në Kretë, që të ndreqësh të metat.* Pavli më parë kishte predikuar në Kretë së bashku me Titin. Kur u largua e la Titin në Kretë që të ndreqte punët e kishës. Koha e qëndrimit të Pavlit në ishullin e Kretës ishte e shkurtër, prandaj Titi duhet të ndreqte atë që ishte prishur ose më saktë të përfundonte atë që duhej përfunduar.

-*Të vendosësh në çdo qytet pleq.* Apostull Pavli e këshilloi Titin që në çdo qytet të dorëzonte pleq “*Edhe si u hirotonisën atyre pleq në çdo kishë*” (Veprat e Apostujve 14, 23). Kështu numri i pleqve sa vinte dhe rritej. Ky fakt vërtetohet tek Veprat e Apostujve “*..duke ua dërguar atë pleqve..*” (Veprat e Apostujve 11, 30). Në Dhiatën e Re kemi pleqtë e kishës së Efesit “*Edhe prej Militës dërgoi në Efes e thirri pleqtë e kishës*” (Veprat e Apostujve 20, 17), pleqtë e Jeruzalemit “*Gjë të cilën edhe e bënë, duke ua dërguar atë pleqve me dorën e Varnavës e të Saulit*” (Veprat e Apostujve 11, 30) etj. Dorëzimi i pleqve bëhej me anën e vënies së duarve mbi kokë. Në Dhiatën e Re, sidomos në shkrimet e apostull Pavlit termi episkop shpesh njësohet me termin prezbiter *ἐπίσκοπος*. Kjo ndodh, sepse në kishën e hershme ndryshimi ndërmjet episkopit dhe prezbiterit ishte fare i vogël. Fjala prezbiter është me origjinë hebraike dhe ka kuptimin *plak*, ndërsa termi episkop rrjedh nga greqishtja dhe do të thotë *mbikqyrës*. Kjo fjalë tregon për natyrën mbikqyrëse të shërbesës së episkopit. Episkopët dhe presbiterët kishin si ndihmësa dhjakët. Gradat klerikale të dhjakut, prezbiterit dhe episkopit kanë filluar në shekullin e dytë.

-*Burrë i një gruaje, që ka bij besimtarë.* Në vitet e hershme episkopët qenë të martuar ashtu siç qenë edhe apostujt, por duke

filluar që nga shekulli VI në traditën ortodokse episkopët zgjidhen nga radhët e murgjve. Gjithashtu gratë e tyre duhet të jenë të sjellshme *óâîîß* dhe dinjitoze. Të mos jenë shpifarake dhe të jenë besnike. Të edukojnë fëmijët e tyre me mësimet e kishës etj. Këtë e hasim edhe tek letra drejtuar Timotheut “*Njeri që drejton mirë shtëpinë e tij, që ka fëmijë të bindur me çdo lloj urtësie. Sepse në qoftë se ndonjë nuk di të drejtë shtëpinë e tij, si do të kujdeset për kishën e Perëndisë?*” (I Timotheut 3, 4-5).

-*Që s’përfliten për plangprishës.* Në Dhiatën e Re jepen disa shembuj të plangprishësit “*Më i vogli mblodhi gjithë ç’pati, e iku në dhe të huaj në një vend të largët; dhe atje shpërndau pasurinë e tij duke shkuar jetë plangprishësi*” (Lluka 15, 13), “*Mos u dehni me verë, në të cilën ka plangprishje*” (Efesianëve 5, 18), “*Bashkë me ata në po atë vërshim të plangprishjes*” (I Petros 4, 4) etj. Mbi plangprishësit do të bjerë ligji i Perëndisë “*Duke ditur këtë, se ligji nuk është vënë për të drejtin, po për të paudhët e për të pabindurit, për ata që s’kanë frikë Perëndinë e për mëkatarët*” (I Timotheut 1, 9). Nëse ka ndonjë rast të tillë, prezbiteri duhet ti qortojë me qëllim që të bëhen shembull për të tjerët “*Ata që mëkatojnë qortoi përpara të gjithëve, që të kenë frikë dhe të tjerët*” (I Timotheut 5, 20).

-*Episkopi duhet të jetë i pafajshëm, si kujdestar i Perëndisë.* Në greqisht termi episkop *ἀρχιεπίσκοπος* do të thotë mbikqyrës. Kandidatët për episkopë, përveç cilësive që kërkojnë kanonet e Kishës duhet të jenë të diplomuar prej një Fakulteti Teologjik Ortodoks. Episkopi duhet të jenë të panjollësuar dhe me reputacion të mirë. Në hirotonisjen e episkopit duhet të marrin pjesë të paktën dy episkopë. Me termin *i pafajshëm* kuptojmë jetën personale të episkopit, ndërsa me *kujdestar i Perëndisë*

kuptojmë “Kështu le të na llogarisë çdo njeri, si shërbëtorë të Krishtit, dhe si kujdestarë të mistereve të Perëndisë” (I Korintasve 4, 1).

-Jo i vrazhdë, jo zemërak, jo pijanec, jo grindës, jo njeri që lakmon. Këto janë disa vese që duhen luftuar. Episkopi nuk duhet të jetë zemrak “Sepse zemërimi i njeriut nuk bën drejtësinë e Perëndisë” (Jakobi 1, 20). Episkopi nuk duhet të jepet pas verës. Atë e ftojnë nëpër gosti të ndryshme dhe nuk duhet ta kalojnë masën e pijes. Episkopi duhet të ketë kujdes sepse shumë sjellje të pakontrolluara, të dhunshme dhe imorale vijnë prej pijes. Gjithashtu episkopi nuk duhet të jetë grindavec “Edhe kur mëkatoni ju kështu ndaj vëllezërive, dhe plagosni ndërgjegjen e tyre të dobët, në Krishtin keni mëkatuar” (I Korintasve 8, 12). E rëndësishme për një prelat të kishës është që ai të mos jetë argjendashës. Në lidhje me këtë apostull Pavli na mëson: “Argjend ose ar ose rrobë as prej ndonjërit prej jush nuk dëshirova” (Veprat e Apostujve 20, 33).

-Dorëhapët, mirëdashës, i urtë, i drejtë, i shenjtë, i përmbajtur. Episkopi duhet të jetë mikpritës “I dashur, punë me besnikëri bën për vëllezërit e të huajt” (III Joanit 5). Gjithashtu duhet të jetë mirëdashës *oëëÛãàèiï* “Dashuria le të jetë pa hipokrizi; urreni të ligën, ngjituni pas së mirës” (Romanëve 12, 9). Të jetë i urtë dhe të ketë gjykim të drejtë në kuptimin e gjërave dhe i drejtë. I drejtë është ai që plotëson detyrat e tij ndaj Perëndisë dhe ruan porositë. Episkopi duhet të jetë i shenjtë “Dhe vishni njeriun e ri, që është ndërtuar sipas Perëndisë me drejtësi e me shenjtëri të së vërtetës” (Efesianëve 4, 24) dhe i përmbajtur.

-Të mundë dhe të nxisë të tjerë me anë të mësimit të shëndoshë. Episkopi është një mësimpldhënës i grigjës së tij (I Timotheut 3, 2). Me anën e predikimeve, katekizmit, bisedave, artikujve në organet e kishës, librave etj, ai i mëson anëtarët e kishës. Në Shkrimin e Shenjtë thuhet: “...jini gati përherë të mbronit me butësi e me frikë cilindo që të kërkojë prej jush fjalë për shpresën që është ndër ju” (I Petros 3, 15). Sigurisht që episkopi me jetën e tij të shenjtë bëhet shembull i mirë për të krishterët.

*-Të qortojë ata që flasin kundër. Çfarë na mëson Shkrimi i Shenjtë për kundërshtarët *átôééYáũîôáo* “Njeri që mëson me butësi ata që kanë mendime të kundërta, dhe kështu mbase u jep atyre Perëndia pendim, që të njohin të vërtetën” (II Timotheut 2, 25).*

Të pabindurit (1, 10-16)

10 Sepse janë shumë të pabindurit që flasin fjalë të kota e që prishin mendjen, më fort ata që janë nga rrethprerja, 11 të cilëve duhet t’u mbyllim gojën; të cilët përmbysin shtëpi të tëra, duke mësuar sa nuk duhen, për fitim të tyre të ndyrë. 12 Një nga ata, profet i tyre, tha: “Kretasit janë gjithnjë gënjeshtarë, bisha të liga, barqe përtace”. 13 Kjo dëshmi është e vërtetë. Për këtë shkak qortoi ata ashpër, që të shëndoshen në besim; 14 edhe të mos u vënë vesh përrallave të Judenive dhe porosive të njerëzve që i kthejnë krahët së vërtetës. 15 Për të pastrit të gjitha janë të pastra; po për të ndyrët e të pabesët asgjë s’është e pastër, por edhe mendja edhe ndërgjegjia e tyre janë të ndyra. 16 Pohojnë me gojë se njohin Perëndi, po

me veprat e mohojnë, sepse janë të ndyrë dhe të pabindur, dhe në çdo punë të mirë të paprovuar.

-Sepse janë shumë të pabindurit. Për të mposhtur të pabindurit Titi duhet të shtonte numrin e mësuesve të vërtetë duke emëruar pleq në çdo qytet. Këta të fundit do të kudërshtonin të pabindurit.

-Flasin fjalë të kota e që prishin mendjen. Këta njerëz përhapin mësimet rreme dhe pa vlerë, prandaj quhen “Prej të cilave disa veta u larguan e u kthyen në fjalë të kota” (I Timotheut 1, 6).

-Më fort ata që janë nga rrethprerja. Besimtarët qenë të rrethprerë iβ âê ðãñéôûÐò “Edhe u mahnitën besimtarët që ishin prej rrethprerjes, sa kishin ardhur bashkë me Pjetrin, se edhe në kombet u derdhka Shpirti i Shenjtë” (Veprat e Apostujve 10, 45). Me këtë term nuk nënkuptojmë judenjtë në përgjithësi, por vetëm ata që kishin pranuar krishterimin. Në Kretë kishte shumë judenj (Veprat e Apostujve 2,11).

-Të cilët përmbysin shtëpi të tëra. Këtë rast e hasim edhe tek letrat dërguar Timotheut (I Timotheut 5, 13 dhe II Timotheut 3, 6).

-Kretasit janë gjithnjë gënjeshtarë, bisha të liga, barqe përtace. Këtë shprehje e ka thënë Epimenidi, nga Kreta. Ky i fundit ka lindur në Knoso dhe ka jetuar në shekullin VI para Krishtit. Kur ishte i vogël babai e dërgoi të gjente delen e humbur. Gjatë kërkimit e zuri gjumi në një shpellë dhe u zgjua pas 40-vjetësh. Pasi u zgjua kishte dhuntinë e profecisë.

-Të mos u vënë vesh përrallave të Judenjve. Njerëzit e asaj kohe u besonin përrallave të judenjve “Edhe ca veta që zbritën

nga Judea mësonin vëllezërit se: Në mos u rrethpërfshi sipas zakonit të Moisiut, nuk mund të shpëtoni” (Veprat e Apostujve 15, 1). Ose të tjerë u besonin përrallave dhe gjenealogjive “As të mos u vënë vesh përrallave e gjenealogjive që s’kanë të mbaruar, të cilat sjellin grindje më tepër se ndërtim në besimin e Perëndisë, kështu bëj” (I Timotheut 1, 4).

-Për të pastrit të gjitha janë të pastra. Farisenjtë e çmonin pastërtinë e jashtme dhe linin pas dore pastërtinë e brendshme dhe atë morale. “S’ka asgjë nga përjashta njeriut që hyn tek ai që mund ta ndyjë, po ato që dalin prej tij, ato janë që e ndyjnë njeriun” (Marku 7, 15). Parësore është pastërtia e zemrës “Lum ata që kanë zemër të pastër, sepse ata do të shohin Perëndinë” (Matheu 5,8).

-Pohojnë me gojë se njohin Perëndi, po me veprat e mohojnë. Të pabindurit janë hipokritë, sepse me gojë e pohojnë se njohin Perëndinë, por me vepra e mohojnë atë. Besimi pa vepra nuk ka vlerë “Që në dukje janë të përkushtuar, po fuqinë e tij e kanë mohuar” (II Timotheut 3, 5).

KREU IDYTË

Cilësitë e një kiske të shëndoshë (2, 1-10)

1. Po ti fol ato që duhet për mësimin e shëndoshë. 2 Pleqtë të jenë të përmbajtur, të sjellshëm, të urtë, të shëndoshë në besim, në dashuri, në durim. 3 Gjithashtu edhe plakat të kenë sjellje siç u ka hije shenjtorëve; të jenë jo shpifëse, jo të dhëna shumë pas verës, të jenë mësuese të mira, 4 që të mësojnë të rejat të duan burrat e djemtë e tyre, 5 të jenë të urta, të pastra, shtëpiake, të mira, të bindura ndaj burrave të tyre, që të mos shahet fjala e Perëndisë. 6 Të rinjtë gjithashtu nxiti të jenë të urtë. 7 Në të gjitha tregojë veten tënde shembull punësh të mira, duke ruajtur në mësim paprishje, nder, 8 fjalë të shëndoshë e të padënueshme, që të turpërohet ai që është kundër, e të mos ketë të flasë për ju asgjë të ligë. 9 Shërbëtorët t'u binden zotërinjve të tyre, në të gjitha punët të jenë të pëlqyeshëm, të mos flasin kundër; 10 të mos e bëjnë të tyren gjënë e huaj, po të tregojnë çdo devotshmëri, që të stolisin në gjithçka mësimin e Perëndisë, Shpëtimtarit tonë.

-Po ti fol ato që duhet për mësimin e shëndoshë. Pavli e këshillon Titin që tu mësojë kretasve doktrinën e shëndoshë. Në vijim ai i jep disa udhëzime etike, të cilat duhet t'ua transmetojë grupimeve të moshave të ndryshme. Pavli përmend

gjashtë kategori njerëzish, duke i ndarë sipas moshës, gjinisë dhe punës. Një paralelizëm të tillë e hasim edhe tek (I Timotheut 5, 1-2).

-Pleqtë të jenë të përmbajtur, të sjellshëm, të urtë, të shëndoshë në besim. Pleqtë duhet të jenë të përmbajtur dhe dinjitozë. Të jenë të urtë dhe të fortë në besim. Titi në grigjën e tij ka shumë pleq, të cilët janë në moshën e babait të tij, prandaj ndaj tyre duhet të tregojë kujdes.

-Plakat të kenë sjellje siç u ka hije shenjtorëve. Plakat duhet të kenë sjellje si u ka hije shenjtorëve. Në kishë vijnë edhe plakat, të cilat duhet t'i konsideronte si nënën e tij. Titi nuk duhet të bënte dallime dhe diferencime ndaj plakave.

-Të mësojnë të rejat të duan burrat e djemtë e tyre. Lindja e fëmijëve do t'i bëjë ato më të lidhura me familjen dhe nuk do të kenë kohë të tepërt të merren me gjëra të kota. Lindja e fëmijëve është një kryq i rëndë për çdo nënë të re, sepse përveç përkujdesjes dhe rritjes së fëmijës ajo do të kujdeset edhe për shtëpinë.

-Të jenë të urta, të pastra, shtëpiake. Apostull Pavli porositi gratë e reja të bëhen zonja shtëpie.

-Të bindura ndaj burrave të tyre. Apostull Pavli i këshillon gratë të bëjnë bindje ndaj burrave të tyre. “Sepse kështu dikur edhe gratë e shenjta, ato që shpresonin tek Perëndia, stolisin veten e tyre, duke iu bindur burrave të tyre; siç i bindej Sara Abrahamit, duke e quajtur atë zot” (I Petros 3, 5-6).

-Të rinjtë gjithashtu nxiti të jenë të urtë. Me të rinjtë Titi duhet të sillet sikur të qenë vëllezërit e tij, prandaj apostull Pavli e këshillon. Duhet shumë kujdes me sjelljen ndaj të rinjve,

sepse ata janë të ndjeshëm ndaj kritikave, prandaj Titi duhet të tregonte shumë dashuri.

-Në të gjitha tregojë veten tënde shembull punësh të mira. Apostull Pavli e këshillon Titin që të jetë shembull. Që të nxiten në besim të rinjtë kanë nevojë për modele. Vetë Pavli imitonte Krishtin *“Më imitoni mua, sikurse edhe unë Krishtin”* (I Korintasve 11, 1).

-Të turpërohet ai që është kundër. Titi duhet të jetë serioz dhe të ketë ndikim tek të rinjtë. Ai duhet të ketë integritet dhe të folur të shëndoshë, me qëllim që të mos qortohet.

-Shërbëtorët t’u binden zotërinjve të tyre. Kisha e hershme duhet të përballonte edhe problemet e sklleverve, sepse shoqëria ishte e ndarë në zotërinj dhe robër. Pavli e këshillon Titin se sklleverit duhet të tregojnë nderim për zotërinjtë e tyre. Kjo të bëhet për arsye shpirtërore, sepse edhe Krishti nga përlësia që e karakterizonte e ka quajtur veten shërbëtor *“Por zbrazti veten e tij duke marrë formë shërbëtori, duke u bërë i ngjashëm me njerëzit”* (Filipianëve 2, 7), madje skllavi i të gjithëve *“Edhe kush të dojë prej jush të bëhet i parë, do të jetë shërbëtor i të gjithëve”* (Marku 10, 44). Sklleverit qenë nën zgjedhën e zotërisë së tyre, i cili mund ti blinte dhe ti shiste kur të donte. Zgjedha simbolizon regjimin shtypës, por Krishti me anën e doktrinës së tij thekson se zgjedha që ofron krishterimi është e lehtë për tu mbajtur *“Ngrini zgjedhën time mbi veten tuaj, dhe mësoni prej meje, se jam i butë dhe i përvulur në zemër. Edhe do të gjeni prehje në shpirtrat tuaj. Sepse zgjedha ime është e mirë, dhe barra ime është e lehtë”* (Matheu 11, 29-30). Sklleverit dhe zotërinjtë kanë një Zot, i cili nuk tregon anësi *“Edhe ju zotërinjtë, po ato bëni për ata, duke lënë*

kërcënimet; sepse e dini, se edhe ju vetë keni Zot në qiejt, dhe ai s'ka anësi" (Efesianëve 6, 9). Zotërinjtë duhet të jenë të drejtë dhe të tregohen të arsyeshëm me skllëverit që kanë nën zgjedhë *"Ju zotërinjtë jepuni shërbëtorëve tuaj të drejtën dhe sa u bën, duke ditur se edhe ju keni Zot në qiejt"* (Kolosianëve 4, 1).

-Të mos e bëjnë të tyren gjënë e huaj, po të tregojnë çdo devotshmëri. Shërbëtorët duhet të jenë të sinqertë dhe të mos përvehtësojnë sendet e zotërinjve të tyre.

-Të stolisin në gjithçka mësimin e Perëndisë, Shpëtimtarit tonë. Ndonëse pozita e skllavit është degraduese, Pavli i porositi që të sillen mirë ndaj zotërinjve të tyre. Shërbyesit duhet të jenë të sinqertë dhe të besueshëm.

Hiri shpëtues u shfaqet të gjithëve (2, 11-15)

11 Sepse u duk hiri i Perëndisë që sjell shpëtim në gjithë njerëzit, 12 i cili na mëson të mohojmë pabesinë dhe dëshirat e botës, e të rrojmë me urtësi e me drejtësi e me përkushtim në këtë jetë, 13 duke pritur shpresën e lumtur dhe dukjen e lavdisë së të madhit Perëndi dhe të Shpëtimtarit tonë Jisu Krisht; 14 i cili dha veten e tij për ne, që të na shpërblejë prej çdo paudhësie, dhe të pastrojë për veten e tij një popull të zgjedhur, të zellshëm për punë të mira. 15 Këto fol dhe porositi dhe qorto me çdo pushtet; asnjëri le mos të të përçmojë.

-Hiri i Perëndisë që sjell shpëtim në gjithë njerëzit. Hiri është dhuratë e Shpirtit të Shenjtë. Pasi është dhuratë ofrohet për të gjithë njerëzit pa dallim. Hiri i Perëndisë në

Dhiatën e Re i është shfaqur Marisë “*Edhe engjëlli i tha: Mos u tremb, Mariam; sepse gjete hir pranë Perëndisë*” (Lluka 1, 30), foshnjës hyjnore “*Edhe djali rritej e forcohej në shpirt, duke u mbushur me urtësi; dhe hiri i Perëndisë ishte mbi të*” (Lluka 2, 49) etj. Hiri i Perëndisë vjen nëpërmjet Krishtit “*Sepse ligji u dha me anë të Moisiut, po hiri dhe e vërteta u bë me anë të Jisu Krishtit*” (Joani 1, 17). Perëndia dëshiron që të gjithë njerëzit të shpëtojnë, por kjo varet nga veprat e gjithsecilit. Të gjithë do të shpëtojnë nëse pendohen për veprimet mëkatore. “*Zoti nuk e vonon premtimin e tij, siç e konsiderojnë disa për vonesë; por tregon zemërgjerësi për ne, sepse nuk do që të humbasin disa veta, por të gjithë të vijnë në pendim*” (II Petros 3, 9).

-*Të mohojmë pabesinë dhe dëshirat e botës. Këtë e hasim edhe tek (Timotheu 5, 8). Mohimet dhe pohimet i kemi bërë në momentin që jemi pagëzuar. “E mohon satananë dhe gjithë veprat e tij...” Dëshirat e borës duhen mohuar “Në qoftë pra se vdiqët bashkë me Krishtin nga elementët e botës, përse duke jetuar në botë jeni nën urdhra” (Kolosianëve 2, 20).*

-*Duke pritur shpresën e lumtur dhe dukjen e lavdisë së të madhit Perëndi. Këtë shprehje e hasim tek (Lluka 2, 25). Shfaqja e lavdisë është plotësimi i shpresës, të cilën e kemi përfituar me hirin e Perëndisë “Sepse ka për të ardhur Biri i njeriut në lavdinë e Atit të tij bashkë me engjëjt e tij dhe atëherë do t’ia shpërblejë gjithësecilit sipas punës së tij” (Matheu 16, 27).*

KREU I TRETË

Udhëzime të përgjithshme (3, 1-3)

1. Kujtoju atyre t'u nënshtrohen autoriteteve e pushteteve, t'u binden atyre, të jenë gati për çdo punë të mirë. 2 Asnjërin të mos shajnë, të mos zihen, të jenë të butë, duke treguar çdo butësi për gjithë njerëzit. 3 Sepse edhe ne ishim njëherë të marrë, të pabindur, të gënjyer, duke u shërbyer dëshirimeve të ndryshme e kënaqësive, duke shkuar jetën në ligësi e në smirë, të mërzhitur e duke pasur mëri njëri-tjetritin.

-Kujtoju atyre t'u nënshtrohen autoriteteve e pushteteve. Apostull Pavli gjatë qëndrimit në ishullin e Kretës me siguri që u ka folur të krishterëve për këtë temë, prandaj këshillon Titin me duke i thënë: -kujtohu atyre. Shkrimi i Shenjtë na mëson: "...çdo njeri le t'i nënshtrohet pushteteve të mësipërm, sepse nuk ka pushtet veçse prej Perëndisë; dhe pushtetet që janë janë caktuar nga Perëndia. Prandaj ai që i kundërvihet pushtetit i kundërvihet urdhërit të Perëndisë..." (Romakëve 13, 1-2).

-T'u binden atyre, të jenë gati për çdo punë të mirë. "Sepse pushtetarët nuk janë për të futur frikë për punët e mira, po për të ligat. Do pra të mos kesh frikë nga pushteti? Bëj të mirën, dhe do të lavdërohesh prej tij. Sepse pushtetari është shërbëtor

i Perëndisë për të mirën tënde. Po nëse bën të keqen, frikësohu; sepse ai nuk e mban më kot thikën; sepse është shërbëtor i Perëndisë në zemërim, shpaggimmarrës ndaj atij që kryen të keqen. Prandaj është e nevojshme të ulni kryet, jo vetëm për shkak të zemërimit, po edhe prej ndërgjegjes” (Romakëve 13, 3-5). Por krishterimi predikon: “Atëherë Pjetri dhe apostujt e tjerë u përgjigjën e thanë: Duhet t’i bindemi Perëndisë më tepër se njerëzve” (Veprat e Apostujve 5, 29).

*-Të mos shajnë, të mos zihen, të jenë të butë, duke treguar çdo butësi për gjithë njerëzit. Blasfemia është sharrja ndaj njerëzve dhe sendeve të shenjta. Blasfemia njollos jo vetëm shpirtin, por edhe gjuhën që i nxjerr ato fjalë “Prandaj ju them juve: Çdo faj e çdo sharje do t’u ndjehet njerëzve; po sharja kundër Shpirtit të Shenjtë nuk do t’u ndjehet njerëzve” (Matheu 12, 31). Apostulli Pavli këshillon që krishterët të jenë të butë *ἀειεὐαγίστο* ashtu siç ishte Krishti “Ngrini zgjedhën time mbi veten tuaj, dhe mësoni prej meje, se jam i butë dhe i përlurur në zemër” (Matheu 11, 29). Butësia është fryt i Frymës “Por fryti i Shpirtit është dashuri, gëzim, paqe, zemërgjerësi, ëmbëlsi, mirësi, besnikëri, butësi, vetëpërmbytje; kundër të tillave nuk ka ligj” (Galatsve 5, 23). Krishti gjatë lumërimeve thotë “Lum ata që janë të butë, sepse ata do të trashëgojnë dhenë” (Matheu 5, 5).*

Urdhëresat dogmatike (3, 4-8)

4 Po kur u shfaq mirësia dhe dashuria e Shpëtimtarit tonë Perëndi për njerëzit, 5 jo prej punësh drejtësie që punuam ne, po sipas përdëllimit të tij na shpëtoi, me anë të banjës së

rilindjes, dhe me anë të përtëritjes së Shpirtit të Shenjtë, 6 që e derdhi me dorë të hapët mbi ne me anë të Jisu Krishtit, Shpëtimtarit tonë; 7 që, pasi të dalim të drejtë me anë të hirit të tij, të bëhemi trashëgimtarë sipas shpresës së jetës së përjetshme. 8 Për të besuar është fjala; dhe këto dua t'i vërtetosh, që të kujdesen ata që i kanë besuar Perëndisë të jenë të parë për punë të mira. Këto janë të mirat e të dobishmet për njerëzit.

- Po kur u shfaq mirësia dhe dashuria e Shpëtimtarit tonë Perëndi. Me shprehjen “kur u shfaq” kuptojmë ndërhyrjen e Perëndisë në kohë të caktuara për shpëtimin e njerëzimit. “Po kur u mbush koha, Perëndia dërgoi të Birin, që lindi prej gruaje dhe që ishte nën ligj” (Galatasve 4, 4).

- Sipas përdëllimit të tij na shpëtoi, me anë të banjës së rilindjes. Shpëtimi është dhurata e Perëndisë për njeriun dhe jepet si rezultat i përdëllimit hyjnor.

-Që e derdhi me dorë të hapët mbi ne. Shpirtin e Shenjtë e marrim me anën e pagëzimit në ujë. Tek Veprat e Apostujve na jepet ardhja e Shpirtit të Shenjtë në ditën e pendikostisë. “Edhe mbi shërbëtorët e mi dhe mbi shërbëtoret e mia në ato ditë do të derdh nga Shpirti im” (Veprat e Apostujve 2, 18).

-Me anë të Jisu Krishtit, Shpëtimtarit tonë. Krishti u pati premtuar dishepujve se do tu dërgonte Shpirtin e Shenjtë. Jisu Krishti quhet shpëtimtar, sepse na shpëtoi nga zgjedha e mëkatit.

Udhëzime për të përballuar heretikët (3, 9-11)

9 Po nga diskutime të marra, e gjenealogji njerëzish, e grindje, dhe luftra ligji largohu, sepse janë të padobishme e të kota. 10 Nga njeriu heretik, si ta mësosh një herë e dy herë, hiq dorë, 11 duke ditur se i tilli është i prishur, dhe mëkaton, sepse e ka dënuar veten.

-Po nga diskutime të marra, e gjenealogji njerëzish, e grindje, dhe luftra ligji largohu. Apostull Pavli e këshillon Titin se duhet të shmangë diskutimet e padobishme.

Këtë këshillë e hasim edhe te letra e dytë drejtuar Timotheut 2, 23. “Edhe hiq dorë nga diskutimet e marra e të trasha, duke ditur se ato lindin grindje”.

- Nga njeriu heretik, si ta mësosh një herë e dy herë, hiq dorë. Ungjilli na këshillon që fillimisht ta këshillojmë vëllanë tonë. “Edhe në të bëftë faj yt vëlla, shko dhe qortoje në mes teje dhe të atij vetëm; në të dëgjoftë, e fitove vëllanë tënd”. (Matheu 18, 15). Nëse ai nuk bindej atëherë Titi duhet të shmangej. “Edhe ju lutem juve, vëllezër, të ruheni nga ata që bëjnë përçarje dhe skandale kundër mësimit që keni nxënë ju, dhe largohuni nga ata” (Romakëve 16, 17).

Porosi të veçanta (3, 12-14)

12 Kur të dërgoj Artemain ose Tihikun tek ti, shpejto të vish tek unë në Nikopol, sepse atje vendosa të dimëroj. 13 Juristin Zina dhe Apolloin përcilli me kujdes, që të mos u mungojë atyre asgjë. 14 Edhe le të mësojnë edhe tanët të jenë

të parë për punë të mira për nevojat e domosdoshme, që të mos jenë të pafrytshëm.

-Kur të dërgoj Artemain ose Tihikun tek ti. Me anën e kësaj fraze kuptojmë se sapo Artemai dhe Tihiku të mbërrinin në Kretë, Titi do të nisej të takonte apostull Pavlin. Titi nuk ishte episkop i përhershëm në Kretë, por i dërguari i Pavlit për të ndrequr atë që ishte prishur (1, 5). Emrin e Artemait nuk e hasim askund tjetër në Dhiatën e Re, por duke u nisur nga etimologjia e emrit mund të supozojmë se e kishte origjinën nga Efesi, vendi ku kulti i Artemisës nderohej në mënyrë të veçantë. Sipas një tradite të mëvonshme Artemai bënte pjesë në rrethin e shtatëdhjetë apostujve dhe më pas u hirotonis episkopi i parë i Listrës. Tihiku e kishte origjinën nga Azia e Vogël dhe ka shoqëruar apostull Pavlin nga Maqedonia për në Jeruzalem dhe në vijim në Romë (Veprat e Apostujve 20, 4). Sipas (II Timotheut 4, 12) Pavli e dërgoi Tihikun në Efes, kështu që Artemai vajti në Kretë.

-Shpejto të vish tek unë në Nikopol. Nikopoja ishte vend i njohur klimaterik në Gjirin e Ambrakisë, me vendndodhje aty ku është Preveza e sotme. Ishte një nga qytetet kryesore të Epirit dhe lidhej me Udhën Egnatia nëpërmjet një degëzimi që kalonte nëpër Butrint. Duhet theksuar se Titi ishte episkop në Kretë. Ai u thirr prej Apostull Palit në Nikopojë dhe më pas e gjejmë duke vepruar në Dalmaci, me qëllim që të vizitonte bashkësitë e krishtera të krijuara prej tij, ashtu siç i shkruan edhe Timoteut në letrën e dytë (4, 9-11): “Përpiqu të vish shpejt tek unë, sepse Dhima më la pasi deshi këtë botë dhe iku në Selanik, Kreshenci në Gallati, Titi në Dalmaci. Me mua është

vetëm Lluka, merre Markun edhe sille me vete, sepse e kam shumë të domosdoshëm për shërbesë". Te letra drejtuar Romanëve (15, 19) dëshmohet se apostull Pavli ka predikuar krishterimin në Iliri: *"Nga Jerusalemi deri në Iliri kam kryer shërbimin e Krishtit"*. Qendra të mëdha si Dalmacia, Salona, Dyrrahu, Nikopoja, Butrinti, Apolonia etj, tërhiqnin vëmendjen e misionarëve të krishterimit. Gjithashtu edhe Udhë Egnatia, e cila fillonte nga Durrësi dhe nëpërmjet Selanikut të shpinte në Kostandinopojë luajti një rol vendimtar në përhapjen e shpejtë të krishterimit në trevat e Ilirisë.

-Sepse atje vendosa të dimëroj. Me siguri Apostull Pali ka pasur miq të krishterë në Nikopojë, të cilët e kanë strehuar për të dimëruar aty. Gjithashtu edhe tek (II Timotheut 4, 21) Pavli thekson *"Përpiku të vish përpara dimrit"*.

-Juristin Zina dhe Apolloin. Te ungjilli sipas Llukës (10, 1) tregohet se Krishti kishte shtatëdhjetë dishepuj: *"Edhe pastaj Zoti vuri edhe shtatëdhjetë nxënës të tjerë dhe i dërgoi dy nga dy përpara tij në çdo qytet e vend, ku kishte për të shkuar ai"*. Nga kjo del qartë se Zina dhe Apolloi bënë pjesë në rrethin e shtatëdhjetë dishepujve të Krishtit. Sipas traditës Zina u dorëzua episkop i Dioskopolit. Apolloi ishte hebre me origjinë nga Aleksandria, pra nga hebrenjtë e diasporës (Veprat e Apostujve 18, 24). Në Efes u njoh me Akilën dhe Priskilën, të cilët e futën më thellë në udhën e Perëndisë *"Edhe ky zuri të flasë me guxim në sinagogë. Edhe Akila e Priskila, kur e dëgjuan atë, e morën me vete dhe i treguan udhën e Perëndisë më qartë"* (Veprat e Apostujve 18, 26). Pasi u pagëzua, Apolloi mori emrin Qesar. Fillimisht atë e gjejmë duke predikuar në Efes (Veprat e

Apostujve 18, 24) dhe më pas në Korinth (Veprat e Apostujve 19, 1).

Apolloi u bë aq i famshëm saqë konkuronte edhe vetë apostull Pavlin “*Unë jam i Pavlit, dhe: Unë i Apolloit*” (I Korintasve 1, 12). Vite më vonë apostull Pavli e dorëzoi Qesarin episkop të Durrësit. Në letrën drejtuar Filipianëve theksohet: “*Ju përshëndesin gjithë shenjtorët, po më fort ata që janë nga shtëpia e Qesarit*” (Filipianëve 4, 22). Bashkësia e krishterë e Durrësit në atë kohë ka pasur rreth pesëdhjetë e tetë familje të krishtera. Qesari më vonë u dorëzua episkop i Koronës në Peleponez, pasi dorëzoi në Durrës pasardhësin e tij Astin. Ky i fundit e drejtoi kishën e Durrësit në kohën e perandorit Trajan (98-117).

-Përcilli me kujdes. Mendohet se apostull Pavli i ka nisur me mision në Kretë, Zinën dhe Apolloin që t’i dorëzonin letrën Titit. Ky i fundit pasi të merrte letrën duhet ti përcillte me kujdes duke i furnizuar me ushqimet e nevojshme që duheshin për udhë. Sipas traditës misionarët e krishterimit përcilleshin nga kisha “*Ata pra si u përcollën nga kisha*” (Veprat e Apostujve 15, 3).

Përshëndetjet (3, 15-16)

15 Të përshëndesin të gjithë ata që janë bashkë me mua. Përshëndeti ata që na duan në besim. Hiri qoftë bashkë me të gjithë ju. Amin.

-Të përshëndesin të gjithë ata që janë bashkë me mua. Titi i njihte gjithë bashkëpunëtorët e Pavlit: “Të përshëndet Efvuli dhe Pudi dhe Lini dhe Klaudia, dhe gjithë vëllezërit” (II Timotheut 4, 210. “Ju përshëndesin Timotheu, bashkëpunëtori

im, dhe Luçi, dhe Jasoni e Sosipatri, kushërinjtë e mi. Ju përshëndes në Zotin unë Tertiu që shkrova letrën. Ju përshëndet Gai, i cili më ka pritur mua me gjithë kishën në shtëpi. Ju përshëndet Erazmi, kujdestari i qytetit, dhe vëllai Kuart” (Romanëve 16, 21-23).

-Përshëndeti ata që na duan në besim. Me anën e kësaj fraze kuptojmë se kisha mbështetet në besimin e përbashkët të Shpëtimtarit Krisht “Për formimin e shenjtoreve, për veprën e shërbesës, për ndërtimin e trupit të Krishtit, deri sa të arrijmë të gjithë në unitetin e besimit, dhe të njohjes së Birit të Perëndisë, në njeri të përsosur, në masën e moshës së plotësisë së Krishtit, që të mos jemi më foshnje, që turbullohen e që sillen andej-këtej nga çdo erë mësimi, nga gënjeshtria e njerëzve, nga dinakëria e mjeshtërisë së mashtrimit; po duke thënë të vërtetën me dashuri të rritemi në të gjitha në atë, i cili është kryet, Krishti” (Efesianëve 4, 12-16).

-Hiri qoftë bashkë me të gjithë ju. Amin. Titi do t’ia bëjë të njohur grigjës së tij letrën e Pavlit, i cili i uron dishepullit të tij Titit që Perëndia t’u dhurojë hir ç ~~Ënô~~ ðâôÛ óíý. Bekimi do të bjerë mbi kishën e Kretës. Ata që predikojnë ungjillin kanë nevojë për hirin e Perëndisë me qëllim që t’i ndriçojë në punën e tyre. Të lutemi që këtë hir Perëndia të na e dhurojë edhe ne, që të zgjohemi dhe të rritemi shpirtërisht.

BIBLIOGRAFI

- Azem Qazimi, *Fjalor i Krishterimit*, Plejad, 2010.
- Bibla, Diodati i Ri, përkthimi 1991-94*, La buona Novella, Brindizi.
- Didie Zhyllia, *Fjalori i filozofisë*, shtëpia botuese Enciklopedike, Tiranë 1994.
- Dhiata e Re e zotit edhe Shpëtimtarit t'ënë Jisu Krisht*, kthyerë prej Elinishtesë Shqip ndë të folë toskërisht prej Kostandin Kristoforidhit, botim i KOASH-it, Tiranë 1994.
- Dhjata e Re, Psalmet, Fjalët e Urta*, botimet Lajmi i Mirë, Tiranë.
- Erasmus Schmid, *Concordance to the Greek New Testament*, Astir, Athens 1990.
- Fjalor i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 2006.
- Fjalor Greqisht-Shqip i Dhiatës së Re*, përgatitur për botim nga Joan Lena, Shoqëria Biblike, Tiranë 2007.
- Fori Tërpini, *Si e gjeta rrugën e Dritës*, predikime fetare e morale, Koti, Korçë 2001.
- Fran Luli, *Fjalor Biblik dhe i termave kishtarë*, Camaj-Pipa, Shkodër 2004.
- John R. Stott, *Mesazhi i 1 Timoteut dhe Titit*, Vernon Publishing, 2006.
- Holy Bible*, Good News Edition, The Bible Societies, Nev York 1982.
- Katekizmi i krishterë Orthodhoks*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë, 2006.
- Nestle-Aland, *Novum Testament Graece*, Deutsche Bibelgesellschaft, Stuttgart 1993.
- Protopresviter Tomas Hopko, *Besimi Orthodhoks*, Vëll. 2, Adhurimi, përkthim nga Mitropolit i Korçës Joani, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 1997.

-Protoprezviter Thomas Hopko, *Besimi Orthodhoks*, Vëllimi III, Shkrimi i Shenjtë dhe Historia e Kishës, përkthyer nga Imzot Joan Pelushi, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 2000.

-*Strongs Exhaustive Concordance of the Bible*, World Bible Publishers.

-*The Exhanstive James Strong Concordance of the Bible*, World Bible Publishers.

-*Ungjilli sipas Mateut, sipas Markut, sipas Lukës, sipas Gjonit, Veprat e Apostujve, Libri i Psalmeve, Libri i Fjalëve të Urta*, përktheu dhe shtjelloi Dom Simon Filipaj, Shoqëria biblike Ndërkonfesionale e Shqipërisë, Tiranë 1999.

-Xavier Leon-Dufor, *Fjalor i Teologjisë Biblike*, Chrigo, Napoli 2009.

PASQYRA E LËNDËS

Parathënie

KREU I PARË

Drejtimi dhe përshëndetjet (1, 1-4)

Zgjedhja e barinjve në kishën e Kretës (1, 5-9)

Të pabindurit (1, 10-16)

KREU I DYTË

Cilësitë e një kiske të shëndoshë (2, 1-10)

Hiri shpëtues u shfaqet të gjithëve (2, 11-15)

KREU I TRETË

Udhëzime të përgjithshme (3, 1-3)

Urdhëresat dogmatike (3, 4-8)

Udhëzime për të përballuar heretikët (3, 9-11)

Porosi të veçanta (3, 12-14)

Përshëndetjet (3, 15-16)

Bibliografia

Pasqyra e Lëndës

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Llukani, Andrea

Redaktor: Dr. Moikom Zeqo

Dikush duhet të ndreqë atë që është prishur,

Andrea Llukani, Tiranë:

Botimet “Trifon Xhagjika”, 2011

34 f, 20 cm.

ISBN